



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 30.07.2014

PËR

MIRATIMIN E LEJES ZHVILLIMORE KOMPLEKSE PËR PROJEKTIN E  
ZBATIMIT TË FAZËS SË PARË TË VIJËS BREGDETARE TË QYTETIT TË VLORËS

Në mbështetje të neneve 6, 8, 70/8 dhe 70/11 të Ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 502, datë 13.07.2011 “Për Miratimin e Rregullores Uniforme të Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes Zhvillimore Komplekse për projektin e zbatimit të Fazës së Parë të Vijës Bregdetare të Qytetit të Vlorës, me subjekt kërkues Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Materiali i plotë grafik bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Bashkia e Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

